



Pranimi / Dostava Priloge / Priloge Attachment / Attachment		17-01-2022	2
Organ / Organizacija Org. / Org.	Id. Prot. Id. Prot. No.	Shkup / Shkup Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRSHICK	176/2022		1/3

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1192/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar - Malore Gashi – Bajraktari, Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 228/2020, të datës 12.08.2020, të ankueses sipas Aktgjykimit A. Nr.1617/2020, të datës 09.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative, me përfaqësues juridik avokatit kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “ ndërprerjeje e marrëdhënies se punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në scancën për këshillim dhe votim me datë 17.01.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 228/2020 e datës 12.08.2020, e parashtruar nga ankuesja sipas Aktgjykimit A. Nr.1617/2020, të datës 09.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative.
- II. SHFUQIZOHET, Vendimi i datës 28.07.2020, me numër protokolli 14-01-124810 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 12.08.2020 me numër protokolli 1524/2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, nga organi i punësimit Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.09.2020, me numër protokoli 1895/2020, ka njoftuar përfaqësuesin juridik avokatin Naim Spahiu, , se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 228/2020, të datës 12.08.2020, për ankuesen për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 24.09.2020, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 09.12.2021, A. Nr. 1617/2020, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 24.09.2020, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 228/2020, të datës 12.08.2020, të ankuesit

Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 228/2020 e parashtruar më datë 15.08.2020 me numër protokoli 1524/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr.1617/2020, të datës 09.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative Vendimi i datës 28.07.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesë e datës 16.07.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimi i datës 09.07.2020; E maili i datës 09.07.2020; Kërkesë e datës 22.07.2020; Akt Emërimi i datës 24.05.2019; Njoftimi i datës 24.09.2020, i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 07.09.2020, me numër protokoli 1701/2020, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar Aktgjykimin e datës 09.12.2021, A. Nr. 1617/2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 24.09.2020, të Këshillit, me të cilin aktgjykim Këshillin e ka obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 228/2020, të datës 12.08.2020, të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar nga shkresa e lëndës përkatësisht nga lista e pagave se ankuesja është larguar nga lista e pagave prej muajit Korrik, të vitit 2019, dhe është deklaruar me zero (0), ndërsa ankesën e ka parashtruar në Komunën e Prishtinës me datë 22.07.2020, gjegjësisht tek Komisioni Për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që i bie plotë 12 muaj pas largimi nga lista e pagave, e që është plotësisht jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi.

Prandaj Kolegji konstaton se veprimet juridike gjegjësisht paraqitja e ankesës nga ana e ankueses është në kundërshtim me nenin 127, s paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ**", si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, i cili përcakton se: **"Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"**.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka bërë shfuqizimin e Vendimit të datës 28.07.2020, me numër protokollit 14-01-124810 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, për shkak se është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi, për shkak se KZAK nuk ka konstatuar gjendjen faktike dhe ligjore se ankesa nga ana e ankueses është parashtruar në komision jashtë afatit të paraparë ligjor, sipas dispozitave të lartshënuara.

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*  
*Lënda Nr. A. Nr.1192/2021*

*Ruslir Kajdazi*

*Procesmbajtës*



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit juridik avokatit
- Gjykatës Themelore-Prishtinë, Gjyqtarit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së





Prindori / Reference Prillogje / Decizije Protokol / Protocol	17. 01. 2022	2	vit god vite
Organ / Nositari Organ / Institution Org / Unit	SKPM/SHCK	176/2022	1/3
Num. Dred / In. No.			
Shlyerja Filing Appendix			
Sasia Kopjura Quantity			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.br.1192/2021

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova – Veçe za razmatranje žalbi u sastavu: Eshref Shabani, predsednik - Malore Gashi – Bajraktari i Arben Mehmeti - članovi, Rushit Kajtazi, viši službenik za stručnu saradnju, u svojstvu zapisničara za razmatranje žalbe A.br.228/2020 od dana 12.08.2020.godine, podnosioca žalbe prema Presudi A.br.1617/2020 od dana 09.12.2021.godine, Osnovnog suda u Prištini/Odeljenje za administrativne poslove, sa pravnim zastupnikom advokatom protiv organa poslodavca Opštine Priština, po pravnoj stvari "prekid radnog odnosa", postupajući u skladu sa članom 6, članom 16. I članom 18, stav 1 podstav 1.1 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru za civilnu službu Kosova i Uredbe br.02/2018 o Pravilima i Žalbenim procedurama u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, na sednici za savetovanje i glasanje, dana 17.01.2021.godine, donosi ovu:

**ODLUKU**

**I. ODBIJA SE** kao neosnovana žalba broj A.br.228/2020 od dana 12.08.2020.godine, podneta od podnosioca žalbe shodno Presudi A. br.1617/2020 od dana 09.12.2021.godine, doneta od Osnovnog suda u Prištini/Odeljenje za administrativne poslove.

**II. STAVLJA SE VAN SNAGE** odluka od dana 28.07.2020.godine, broj protokola 14-01-124810 Komisije za rešavanje sporova i žalbi u Opštini Priština.

**O b r a z l o ž e n j e**

je dana 12.08.2020.godine pod brojem protokola 1524/2020, podnela žalbu Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, navodeći žalbene tvrdnje u vezi prekida radnog odnosa, od strane organa poslodavca Opštine Priština.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, dana 24.09.2020.godine, broj protokola 1895/2020, obavestio je pravnog zastupnika advokata da ne može razmatrati i odlučivati u vezi žalbe A.br.228/2020, od dana 12.08.2020.godine, za podnosioca žalbe jer Odbor nema članove, upućujući podnosioca žalbe da se obrati Osnovnom sudu u Prištini/Odeljenju za administrativne poslove.



**Pravna pouka:** Protiv oduke Odbora, nezadovoljna stranka koja tvrdi da je odluka Odbora nezakonita, može pokrenuti upravni spor u Osnovni sud u Prištini-Odeljenje za Administrativne poslove, u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke.

*Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova  
Predmet br. A.bNr.1192/2021*

*Rushit Kajtazi*

*Zapisničar*

*Eshref SHABANI*

*Predsednik Veka*



**Odluku dostaviti:**

- Pravnom zastupniku advokatu
- Osnovnom sudu –Priština, sudiji
- Predsedniku Opštine Priština;
- Kadrovskom rukovodiocu u Opštini Priština;
- Arhivi NNOCSK-a.

Preveo:

*Sh. Mujko*

Sh.Mujko

Dana, 18.01.2022.god.